

VENDIM
Nr. 37/2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 98/2014, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT
CIVIL”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar, si dhe nenit 11, pika 4, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 98/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

Lidhja nr. 2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Komisioneri	<u>1</u>	I-F
Ligj nr. 9584, dt. 17.07.2006, i ndryshuar me ligjin nr. 34/2023.		
II. Kabineti	<u>(2)</u>	
Këshilltar	1	I-4
Sekretar	1	
III. Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes		<u>(21)</u>
Drejtor i Përgjithshëm	1	I-4
III/1. Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ		<u>(7)</u>
Drejtor	1	II-1
Inspektor	6	III-1
III/2. Drejtoria e Mbikëqyrjes	<u>(7)</u>	
Drejtor	1	II-1
Inspektor	6	III-1
III/3. Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit		<u>(6)</u>
Drejtor	1	II-1
Inspektor	5	III-1
IV. Drejtoria e Çështjeve Juridike	<u>(5)</u>	
Drejtor	1	II-1
Specialist	4	IV-1
V. Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse		<u>(8)</u>
Drejtor	1	II-1
Specialist (IT)	1	IV-1

Specialist (Marrëdhëniet me Publikun dhe Burimet Njerëzore)	1	IV-1
Specialist (Financë/Buxhet)	1	IV-1
Specialist Arkiv/Protokoll	1	IV-3
Punonjës Mirëmbajtjeje	1	VKM 326, dt. 31.05.2023
Shofer	1	VKM 326, dt. 31.05.2023
Pastrues	1	VKM 326, dt. 31.05.2023
Gjithsej	37 punonjës	
